



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:232630

Datë: 26.06.2024

Numri i dokumentit: 05864688

Ac.nr.1740/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Robertina Lekaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.A., nga fshati S., Komuna e Vushtrrisë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson N.M., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës K.S. “S.”, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson kompania e avokatëve “A.”, me seli në Prishtinë, me bazë juridike kompensimi i dëmit, duke vendosur sipas ankesës së palës së paditur të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri, C.nr.316/2018, të datës 05.01.2021, në seancën e kolegjit me datë 13.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET pjesërisht si e pathemeltë ankesa e të paditurës K.S. “S.”, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri, C.nr.316/2018, i datës 05.01.2021, në pikën I të dispozitivit, lidhur me kompensimin për dhimbjet shpirtërore trupore, frikën e përjetuar, shëmtimin trupor, zvogëlimin e përgjithshëm të aktivitetit jetësor dhe ndihmën dhe kujdesin nga ana e personit të tretë, **VËRTETOHET**.

II. APROVOHET pjesërisht si e themeltë ankesa e të paditurës K.S. “S.”, me seli në Prishtinë, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri, C.nr.316/2018, të datës 05.01.2021, në pikën I të dispozitivit që ka të bëjë me kamatën dhe në këtë pjesë gjykohet si në vijim: **DETYROHET** e paditura K.S. “S.”, me seli në Prishtinë, që paditësit F.A., nga fshati S., Komuna e Vushtrrisë, shumat e gjykuara në emër të dëmit material dhe jo material të vërtetuara sipas pikës I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, t’ia paguaj me kamatë ligjore prej 8% në vit, ashtu që kamata për dëmin jo material të llogaritet duke filluar nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë datë 05.01.2021 e deri në pagesën definitive, ndërsa për dëmin material duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë datë 12.07.2018, e deri në pagesën definitive.

III. APROVOHET pjesërisht si e themeltë ankesa e të paditurës K.S. “S.”, me seli në Prishtinë, **PRISHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri, C.nr.316/2018, i

datës 05.01.2021, në pikën I të dispozitivit që ka të bëjë me pjesën ku është vendosur për shpenzimet e shërimit, kompensimin në emër të rentës mujore nga data 13.04.2018 e deri me datën 31.12.2019, dhe rentën mujore duke filluar nga data 01.01.2020, e derisa të ekzistojnë kushtet ligjore, si dhe shpenzimet e procedurës, dhe për këtë pjesë çështja kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

IV. Pika II e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, C.nr.316/2018, të datës 05.01.2021, që ka të bëjë me pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë së paditësit, mbetet e pashqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri, me aktgjykimin e atakuar C.nr.316/2018, të datës 05.01.2021, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit F.A. nga fshati S., Komuna e Vushtrrisë, kundër të paditurës K.S. "S.", me seli në Prishtinë, lidhur me kompensimin e dëmit, ashtu që ka detyruar të paditurën K.S "S.", me seli në Prishtinë, që paditësit F.A. nga fshati S., Komuna e Vushtrrisë, që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 13.04.2018, rreth orës 08:40 në Obiliq, rr..., të ia paguaj shumat për kategoritë si në vijim: në emër të dhimbjeve shpirtërore trupor shumë prej 4000 euro, në emër të frikës së përjetuar shumë prej 2000 euro, në emër të shëmtimit trupor, shumë prej 500 euro, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë, shumë prej 9000 euro, në emër të ndihmës dhe kujdesit nga ana e personit tjetër, shumë prej 340 euro, në emër të shpenzimeve të shërimit, shumë prej 635 euro, në emër të rentës mujore nga data 13.04.2018 e gjer me datën 31.12.2019, shumë prej 4736 euro, gjithsejtë në shumë të përgjithshme për të gjitha kategoritë prej 21,211 euro. Të gjitha këto me kamatë prej 8%, nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, ndërsa nga data 01.01.2020, e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, në emër të rentës mujore të ia paguaj shumë prej 65 euro çdo muaj, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 2730 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm. Në pikën II, ka refuzuar si të pabazuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit F.A. nga fshati S., Komuna e Vushtrrisë, kundër të paditurës K.S. "S.", me seli në Prishtinë, lidhur me kompensimin e dëmit dhe atë përtej shumave dhe kategorive të njohura si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe të: në emër të dhimbjeve shpirtërore trupor shumë prej 1500 euro, në emër të frikës së përjetuar shumë prej 2500 euro, në emër të shëmtimit trupor, shumë prej 2000 euro, në emër të ndihmës dhe kujdesit nga ana e personit tjetër, shumë prej 560 euro, në emër të shpenzimeve të ushqimit të përforcuar shumë prej 420 euro, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësorë, shumë prej 1000 euro, në emër të shpenzimeve të rehabilitimit klimaterik shumë prej 1250 euro, në emër të rentës mujore nga data 13.04.2018 e gjer me datën 31.12.2019, shumë prej 413 euro, gjithsejtë në shumë të përgjithshme për të gjitha kategoritë e refuzuara prej 9643 euro.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë e paditura, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e

Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, aktgjykimin e atakuar ta prish dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur paditësi.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194, 195, dhe 200 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të paditurës është pjesërisht e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 12.07.2018, në gjykatën e shkallës së parë, ka parashtruar padi kundër të paditurës, për kompensimin e dëmit sipas bazës së autopërgjegjësisë, të pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 13.04.2018, në Obiliq. Me parashtruesën e dorëzuar në gjykatë me datë 03.10.2019, si dhe plotësimin e bërë në seancë të datës 21.07.2020, pala paditëse ka bërë precizimin e kërkesëpadi së bazuar në mendimin e dhënë nga ekspertet mjekësor, dhe të aktuaristikës, ashtu që ka kërkuar që të miratohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditësit, dhe të detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensojë në emër të dëmit jomaterial dhe material shumë si në precizim, me kamatë në lartësi prej 8% nga dita e shkakimit të aksidentit e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjyimit e nën kërcënim të përmbarrimit. E paditura përmes përgjigjes në padi e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadi së dhe lartësinë e saj deri në sigurimin e provës-ekspertizës së komunikacionit të nxjerrë në procedurë penale.

Gjykata duke vepruar sipas padisë dhe kërkesëpadi së së precizuar të paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me numër C.nr.316/2018, të datës 05.01.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadi në e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjyimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjyimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se me provat e administruara, është vërtetuar së aksidenti i komunikacionit ka ndodhur me datën 16.04.2018, rreth orës 08:40 minuta, në Obiliq, rr..., i cili aksident është shkaktuar nga i siguruari i të paditurës me policë të sigurimit nr... Gjykata me rastin e caktimit të lartësisë për shpërblimin e dëmit jo material dhe material ka vendosur duke marrë për bazë ekspertizat mjekësore të dhëna nga Dr.S.S., ortoped-traumatolog dhe Dr.N.M.-psikiatër, të cilët kanë dhënë mendimin e tyre profesional me ekspertizën e datës 17.09.2019, lidhur me natyrën, shkallën dhe pasojat e lëndimeve që ka pësuar paditësi si pasojë e këtij aksidenti, i njëjti ka pësuar lëndime të rënda trupore, duke konstatuar se ka pësuar fractura platotibiatis I sin. Fractura multifragmentaria intraarticularis basis MC I mani I sin (Fractura Roland) Compartment Szndroma Cruris I sin, për të cilën është kryer edhe intervenim kirurgjik. Paditësi ka pësuar dhimbje të intensitetit posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje prej 2 orë, dhimbje të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 3 ditë, dhimbje të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 2 muaj, ndërsa dhimbje të intensitetit të ulët ka edhe sot e kësaj dite posaçërisht gjatë ngarkimeve të tepruara. Paditësi, ka përjetuar

frikë primare me kohëzgjatje prej disa sekondave, frikë sekondare të intensitetit të lartë ka përjetuar 3 ditë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm ka përjetuar 1 muaj dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët është prezent edhe sot e kësaj dite. Padiësi ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë në kohëzgjatje prej 2 muaj, për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 2 muaj, ka pasur nevojë për rehabilitim fiziatrik 2 herë nga 3 javë, ndërsa i njëjti ka pasur shëmtim trupor në shkallë të lehtë ndërsa ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 18.45%. Gjykata e shkallës së parë, ka nxjerrë ekspertizën mjekësore për vlerësimin e aftësisë së punës të punuar nga Dr. Xh.Sh., në bazë të cilës konstatohet se padiësi ka zvogëlim të aftësisë së të përgjithshme të punës prej 20.50%, në vitin e parë pas aksidentit paaftësia për punë ka qenë 100%, për 6 muajt vijues të vitit të parë paaftësia për punë ka qenë 50 %, ndërsa tani është 20.50%, duke rekomanduar që bëhet rivlerësimi pas 5 viteve. Tutje gjykata ka nxjerr edhe ekspertizën aktuaristikës nga eksperti A.B., në bazë të cilës konstatohet se padiësit përveç lëndimeve i është shkaktuar edhe dëmi në formë të rentës-fitimit të humbur. Gjykata e ka refuzuar pjesërisht kërkesëpadinë e padiësit, si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, për dëmin material dhe jomaterial përtej shumave të gjykuara, sepse bazuar në mendimet e ekspertëve mjekësor dhe nga ekzaminimi direkt në seancë i padiësit, ka vlerësuar se shumata e kërkuara nga padiësi për dëmin jomaterial përtej shumave të gjykuara nuk janë në proporcion me të mirën e shkelur dhe qëllimin e kompensimit.

Gjykata e shkallës së parë, lidhur me bazën juridike të kërkesëpadiës dhe lartësinë e kërkesëpadiës, ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat e nenit 136, 137, 140 të LMD-së, Lidhur me kamatën, gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat e nenit 382 të LMD-së, nenit 9,1.1 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit të Kosovës, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, përveç pjesës për të cilën aktgjykimi i atakuar është dashur të ndryshohet përkatësisht prishet.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat pretendon pala ankuese. Aktgjykimi i atakuar në pjesën vërtetuese nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitiv i aktgjykimit është i qartë dhe arsyetimi përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet vendimtare, të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosur lidhur me themelësinë e kërkesëpadiës. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Gjykata në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ka paraqitur arsye mjaftueshme me lartësinë e

dëmit jo material dhe material, si dhe ka dhënë arsye të mjaftueshme për shumat e aprovuara për llojet e dëmit dhe format e tij të kërkuara nga paditësi.

Gjykata e Apelit vlerëson se janë të paqëndrueshme pretendimet e ankimore të paditurës për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për pjesën e vërtetuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, sepse vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, ku e paditura pas pranimit të ekspertizës së komunikacionit të datës 15.05.2018, të nxjerrë në procedurë penale e cila është përpiluar nga eksperti B.S., nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadsisë. Sipas kësaj ekspertizë është vërtetuar fakti së deri të aksidenti në të cilin paditësi ka pësuar lëndime trupore ka ardhur për shkak të lëshimeve të ngasësit të automjetit “A”, i siguruar tek e paditura, ndërsa lartësinë e kërkesëpadsisë që i referohet shumave të gjykuara për dhimbje fizike, frikën e përjetuar, shëmtimit, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, dhe për ndihëm dhe kujdes të personit të tretë, gjykata e ka vërtetuar në bazë të mendimeve të ekspertëve mjekësor nga lëmi i ortopedisë-traumatologjisë dhe psikiatrisë, të cilët gjatë ekzaminimit e dokumentacionit mjekësor dhe ekzaminimit të paditësit, kanë konstatuar qartë natyrën dhe llojin e lëndimeve trupore, kohëzgjatjen dhe intensitetin e dhimbjeve fizike dhe të frikës, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe të shëmtimit, kohëzgjatjen e nevojës për ndihmën e huaj, andaj edhe kjo gjykatë vlerëson se konstatimet e ekspertëve janë profesionale dhe me sqarime të mjaftueshme, për tu vërtetuar format e dëmit dhe lartësia e tyre, ku në bazë të këtyre konstatimeve gjykata edhe ia ka gjykuar shumat për format e dëmit material dhe jomaterial.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke marrë parasysh natyrën e lëndimeve (të rënda trupore), si dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike dhe frikës, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe të shëmtimit, është vendosur që të vërtetohen shumat e kompensimit në emër të dëmit jo material të shkaktuar, mbështetur edhe në thëniet e ekspertizave mjekësore, ku janë trajtuar këto forma të dëmit. Gjykata ketë vendim e ka mbështetur në nenin 183 par.1 dhe 2 të LMD-së, (Ligji Nr. 04/L-077) i cili decidivisht thotë se: *“Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. Me rastin e vendosjes për kërkesën për shpërblimin e dëmit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”*. Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me natyrën e lëndimit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve të përjetuara, si dhe frikës së palës së dëmtuar, dhimbjeve shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe të shëmtimit duke u bazuar në shkallën e shëmtimit dhe të zvogëlimit, ashtu që kompensimi të përfaqësoj një lehtësim në përballimin dhe tejkalimin e pasojave të dëmit që në këtë rast pala paditëse ka pësuar në aksidentin e ndodhur, e që në të njëjtën kohë, ato të jenë reale dhe të paraqesin satisfakcion të vërtet, për aq sa është e

mundur, duke u shkuar për shtati synimeve shoqërore për kompensimin e dëmit. Në kuptim të kësaj, konstatohet se gjykata e shkallës së parë ka vepruar konform një dispozite të tillë.

Në bazë të dispozitës së nenit 179 par.1 të LMD-së, është paraparë së “*Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit*”. Në rastin konkret rezulton se në mënyrë të drejtë, gjykata e shkallës së parë ka vendosur edhe mbi shumën në emër të dëmit material, për ndihmë të personit të tretë meqë, siç theksohet edhe në ekspertizë mjekësore, paditësi ka pasur nevojë për ndihmë të personit të tretë në kohëzgjatje prej 2 muaj. Edhe pse një formë e tillë e dëmit është më e vështirë për t’u vërtetuar me prova konkrete, praktika gjyqësore e njeh kompensimin e dëmit të tillë, e meqenëse është konstatuar nevoja për ndihmë të personit të tretë, sepse zakonisht për personat e lënduar kujdeset anëtar i familjes, atëherë rrjedhimisht dhe ligjërish, paditësi i takon ky lloj kompensimi. Prandaj, kjo gjykatë vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që vlerëson së shumat e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë sa i përket pjesës së vërtetuar janë adekuate, dhe i përgjigjen dëmit që e ka pësuar paditësi.

Lidhur me vendosjen si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, përkitazi me kamatën, Gjykata e Apelit, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes sa i përket kohës së fillimit të llogaritjes së kamatës për dëmin jomaterial nuk është i drejtë dhe i ligjshëm. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë e ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale sa i përket kohës së fillimit të rrjedhjes së kamatës, për çka në këtë pjesë është dashur që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar konform dispozitës së nenit 382 të LMD-së, pasi që për dëmin material kamata fillon që të rrjedh nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatës (datë 12.07.2018), ndërsa lidhur me dëmin jo material kamata fillon të rrjedh nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit në gjykatën e shkallës së parë (datë 05.01.2021), duke u bazuar në Mendimin Juridike të Gjykatës Supreme të Kosovës për kamatën, nr.265/2020 të datës 01.12.2020, pika XIV dhe XV.

Sa i përket pjesës ku është vendosur për rentën dhe shpenzimet e shërimit, Gjykata e Apelit e ka pranuar si të bazuar pretendimin e të paditurës dhe ka vendosur që aktgjykimi i atakuar në këtë pjesë të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë, rreth mënyrës së vendosjes sa i përket rentës dhe shpenzimeve të shërimit, nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, sepse aktgjykimi i atakuar për këtë pjesë është marrë me vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë për vërtetimin e gjendjes faktike sa i përket rentës sipas propozimit të palës paditëse ka bërë nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmi i mjekësisë së punës dhe të aktuaristikës. Kjo gjykatë duke i vlerësuar pretendimet ankimore të të paditurës ka gjetur së në ekspertizën e aktuaristikës të datës 06.01.2020, të përpiluar nga eksperti aktuar A.B., me të cilën është bërë llogaritja e rentës bazuar në shkallën e zvogëlimit të aftësisë punuese të konstatuar me ekspertizën mjekësore për zvogëlimin e aftësisë punuese të datës 28.11.2019, të përpiluar nga eksperti Xh.Sh., është konstatuar së kjo llogaritje vlen më kusht që

paditësi të jetë në evidencën e të papunëve gjë që duhet të dëshmohet pranë gjykatës me pasqyrën e trustit të kursimeve pensionale, dhe vërtetimit të papunësisë të qendrës komunale për punësim dhe së nuk është as përfitues i ndihmës sociale nga qendra komunale për punë sociale në Vushtrri, në të kundërtën duhet të bëhet llogaritja e re e rentës. Në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk rezulton së paditësi i ka dorëzuar provat e kërkuara në ekspertizën e aktuaristikës në mënyrë që të vlejë llogaritja e rentës ashtu siç është konstatuar në ekspertizë. Andaj me ekspertizën e aktuaristikës të përpiluar pa pasur qasje në provat e cekura me lartë nuk është provuar në mënyrë të plotë gjendja faktike sa i përket lartësisë së rentës, dhe gjykata e shkallës së parë edhe përkundër këtij fakti nuk e ka kthyer ekspertizën në plotësim në mënyrë që e njëjta të bazohet edhe në këto prova, dhe me pas eksperti të jap mendimin definitiv së a vlen renta e llogaritur sipas ekspertizës apo kjo ndryshon, dhe si rrjedhojë i këtij lëshimi ka mbetur pa u vërtetuar në mënyrë të plotë gjendja faktike sa i përket rentës. Gjykata e shkallës së parë ka gjykuar rentën mujore nga data 13.04.2018 e deri me datën 31.12.2019, në shumë prej 4736 euro, dhe nga data 01.01.2020, rentën mujore shumë prej 65 euro çdo muaj e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, duke mos vërtetuar gjendjen faktike nëse paditësi është i punësuar apo i evidentuar në listën e të papunësuarve apo nëse i njëjti është përfitues i ndihmës sociale. Po ashtu, edhe sa i përket shpenzimeve të shërimit kjo gjykatë ka gjetur së gjykata e shkallës së parë ka vendosur për shpenzimet e shërimit pa e vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike, pasi që nuk ka kërkuar sqarime nga ekspertet mjekësor nëse faturat-kuponët të cilët gjenden në shkresat e lëndës i përgjigjen nevojave për mjekim të paditësit, pra nëse këto fatura kanë lidhje kauzale me nevojën për trajtim dhe shërim për shkak të lëndimeve të cilat paditësi i ka pësuar në aksidentin e komunikacionit. Për më tepër, në parashtrësën për precizim të kërkesëpadisë të datës 03.10.2019, paditësi për shpenzimet e shërimit sipas faturave ka kërkuar shumë prej 501.00 euro, ndërsa gjykata i ka njohur shumë prej 635.00 euro. Kjo gjykatë gjeti së paditësi pas parashtrësës për precizim të kërkesëpadisë e cila është bërë pas nxjerrjes së provës me ekspertizë mjekësore nga lëmi i ortopedisë dhe psikiatrisë, paditësi ka dorëzuar edhe disa kupon fiskal në emër të shpenzimeve të shërimit, mirëpo, në bazë të procesverbalëve të seancës së shqyrtimit kryesor nuk rezulton së paditësi e ka rritur kërkesën për shpenzimet e shërimit përtej vlerës prej 501.00 euro, dhe nga kjo rezulton së gjykata e shkallës së parë përveç së nuk e ka vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike ka vendosur edhe jashtë kërkesës së paditësit duke tejkalluar kërkesëpadinë sa i përket lartësisë së gjykuar për shpenzimet e shërimit. Për arsyet e cekura si më lartë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë në pjesën që i referohet rentës dhe shpenzimeve të shërimit, u deshtë që të prishet dhe lënda të kthehet në rivendosje, ngase gjykata e shkallës së dytë në mungesë të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike nuk ka pasur mundësi që në këtë pjesë të njëjtin ta vërtetoj apo ta ndryshoj.

Gjykata ankimore ka kthyer në rigjykim edhe vendimi mbi shpenzimet e procedurës pasi që shpenzimet e procedurës duhet të gjykohen në mënyrë unike për tërë procesin gjyqësor dhe sipas suksesit në procedurë.

Në riprocedurë, udhëzohet gjykata e shkallës së parë që të bëjë eliminimin e shkeljeve të sipër theksuara, të caktoj shqyrtimin kryesor, të kërkojë nga pala paditëse që të bëjë të qartë shumë e kërkesës që e kërkon në emër të shpenzimeve të shërimit, dhe t'i ftoj ekspertët mjekësor që të deklarojnë lidhur me shpenzimet e shërimit, nëse të njëjtat shpenzime i përgjigjen nevojave për

tretman dhe mjekim të paditësi për shkak të lëndimeve të pësuar, të kërkojë nga eksperti i aktuaristikës që ta bëjë plotësimin e ekspertizës në mënyrë që e njëjta të bazohet edhe në provat të cilat eksperti i ka kërkuar e të cilat janë cekur me sipër në mënyrë që të vlejë llogaritja e rentës, dhe me pas të ftohet eksperti aktuar të jap mendimin definitiv së a vlen renta e llogaritur sipas ekspertizës apo kjo ndryshon, e pas kësaj gjykata përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit për shpenzimet e mjekimit si dhe rentën. Gjykata po ashtu në rigjykim sipas kërkesës së palëve në procedurë të vendos në mënyrë të drejtë edhe lidhur me shpenzimet e shkaktuara palëve në procedurë, duke pasur parasysh suksesin e tyre në procedurë dhe shpenzimet të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes së tyre në gjykatë.

Aktgjykimi i atakuar mbetet i pashqyrtuar në pikën II të dispozitivit, që ka të bëjë me pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë së paditësit, pasi që në këtë pjesë nuk ka pretendime ankimore nga palët ndërgjyqëse.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, në mbështetje të dispozitave nga neni 194 dhe 195, paragrafi 1, pika c), d), dhe e) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1740/2021, datë 13.06.2024

Kryetar i kolegjit-Gjyqtari
Hysni Bardheci